



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 30 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Mbrojtjen për Dorëzimin e Përgjigjeve ndaj F00322

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Pejs

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli



TRUPI GJYKUES II (“Trupi Gjykues”), në përputhje me nenin 40 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 79 dhe 116(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 1 dhe 2 shtator 2021, Trupi Gjykues (“Trupi Gjykues”) mbajti një konferencë përgatitore për gjykim (“Konferenca”) në bazë të rregullës 116(2) të Rregullores. Gjatë kësaj Konference, në përputhje me rregullën 117(2), Trupi Gjykues urdhëroi palët të dorëzonin mocionet sipas rregullës 117, nëse kanë, jo më vonë se 17 shtatori 2021.¹
2. Më 17 dhe 18 shtator 2021, Mbrojtja e z. Gucati (“Mbrojtja e Gucatit”)² dhe Mbrojtja e z. Haradinaj (“Mbrojtja e Haradinajt”)³ dorëzuan mocionet e tyre përkatëse që kundërshtonin pranueshmërinë e disa provave materiale të propozuara të Prokurorisë (“Mocionet”).
3. Më 24 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi përgjigjen ndaj Mocioneve (“Përgjigja”).⁴
4. Më 27 shtator 2021, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër me të cilin hodhi poshtë Mocionet (“Urdhri”).⁵

¹ Urdhër për Caktimin e Afatit për Dorëzimin e Mocioneve sipas Rregullës 117, 2 shtator 2021, f. 603, rreshti 21 deri në f. 604, rreshti 1.

² F00317, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion për Kundërshtimin e Pranueshmërisë së Provave sipas Rregullës 138(1)* (“Mocioni i Gucatit”), 17 shtator 2021, konfidencial.

³ F00318, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë sipas Rregullës 117(2) për Mospranimin e Provave të Dëshmitarëve të ZPS-së* (“Mocioni i Haradinajt”), 18 shtator 2021, konfidenciale.

⁴ F00322, ZPS, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kundërshtimeve të Mbrojtjes në lidhje me Pranueshmërinë* (“Përgjigja”), 24 shtator 2021, konfidenciale.

⁵ F00328, Trupi Gjykues, *Urdhër mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117* (“Urdhri”), 27 shtator 2021, para. 18.



5. Më 29 shtator 2021, Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt dorëzuan kërkesa për rishikimin e Urdhrit ("Kërkesat").⁶

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja e Gucatit parashtron se me nxjerrjen e Urdhrit para përfundimit të afatit për dorëzimin e kundërpërgjigjeve, Trupi Gjykses dëmtoi në mënyrë të padrejtë të akuzuarit dhe se arsyetimi i Trupit Gjykses ishte qartësisht i gabuar.⁷ Mbi këtë bazë, Mbrojtja e Gucatit kërkon që Trupi Gjykses t'i lejojë të dorëzojë kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes si dhe të rishikojë Urdhrin, duke marrë parasysh kundërpërgjigjen.⁸

7. Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja e Haradinajt kërkon që Trupi Gjykses t'i lejojë të dorëzojë kundërpërgjigjen dhe ta marrë atë parasysh para se të rishikojë Urdhrin.⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas rregullës 76 të Rregullores, kundërpërgjigja ndaj përgjigjes dorëzohet brenda pesë ditësh prej dorëzimit të përgjigjes dhe Trupi Gjykses mund të marrë në shqyrtim kundërpërgjigjen ose pjesë të saj vetëm nëse kanë të bëjnë me çështje të reja që dalin nga përgjigja.

9. Sipas rregullës 79 të Rregullores, në rrethana të veçanta dhe kur është vërtetuar se një arsyetim është qartësisht i gabuar, apo kur rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë, me kërkesë të një pale, Trupi Gjykses mund t'i rishikojë vendimet e veta.

⁶ F00335, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë për Rishikimin e Vendimit F00328 ("Kërkesa e Gucatit")*, 29 shtator 2021; F338, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Rishikimin e Vendimit F00328 mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117 ("Kërkesa e Haradinajt")*.

⁷ Kërkesa e Gucatit, para. 6, 8-9.

⁸ Kërkesa e Gucatit, para. 2, 11.

⁹ Kërkesa e Haradinajt, para. 32.



10. Sipas rregullës 116(4) të Rregullores, Trupi Gjykses mund të lëshojë çfarëdo urdhrash të nevojshme për garantimin e një gjykimi të drejtë e të shpejtë.

IV. DISKUTIM

11. Për marrjen e vendimit lidhur me Kërkesat, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme t'i autorizojë ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë kundërpërgjigjet e tyre ndaj Përgjigjes.

V. VENDIM

12. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses **URDHËRON** Mbrojtjen e Gucatit dhe Mbrojtjen e Haradinajt t'i dorëzojnë kundërpërgjigjet e tyre ndaj Përgjigjes deri më **4 tetor 2021**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E enjte, 30 shtator 2021

Në Hagë, Holandë